



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, Datë ____/____/2026

PËR

**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 4010444 (KATËR MILIONË E DHJETË MIJË E KATËRQIND E DYZET E KATËR) LEKË TË PARAFINANCUARA NGA
PROJEKTI SUSTAINABLE MOBILITY UPGRADE - SUMO 2.0,
PROGRAMI INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027)**

Në mbështetje të Ligjit nr. 65/2022 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit European për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)”, Ligjit nr. 8/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Evropian, i cili përfaqëson Bashkimin Evropian, për programin e bashkëpunimit (Interreg VI-A) IPA Itali–Shqipëri–Mali i Zi (Adriatiku Jugor) 2021-2027”, Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr.10 datë 12.07.2024 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordinin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, Marrëveshjes së Partneritetit të nënshkruar ndërmjet Partnerit udhëheqës së Projektit Luka Bar AD dhe institucionit të Bashkisë Durrës, nënshkruar më datë 01/09/2025, për projektin “Sustainable Mobility Upgrade 2.0 - SUMO 2.0”, programi i BE-së Interreg IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027), kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe

TË VENDOSË:

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 4,010,444 (katër milionë e dhjetë mijë e katërqind e dyzet e katër) lekë (në vlerën 20% të shumës totale të financimit të projektit nga fondet e

Programit Interreg), të ardhur si parafinancim nga projekti SUMO 2.0., me kod të produktit të projektit G107010 të ardhur nga Dega e Thesarit Durrës dhe të konfirmuar nga Ministria e Financeve. Ky fond do të përdoret sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme:

Gr.	Kap.	Programi	Llog. Ekon	Kodi i programit	Kodi i institucionit	Emri i institucionit	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Fondi në lekë
00	2	Planifiki mi Urban Vendor	231	06140	2107001	Bashkia Durrës	Projekti SUMO 2.0	G107010	4,010,444

2. Kjo shumë të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për zhvillim të aktiviteteve të projektit që lidhen me tre paketa pune kryesore që synojnë përmirësimin e lëvizshmërisë së qëndrueshme dhe lidhjeve port-qytet në Adriatikun Jugor, si: ekspertiza të jashtme dhe shërbime për takime lokale, udhëtime jashtë vendit, kancelari dhe përkthim/noterizim, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit (01/07/2025 – 31/12/2027).
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtoreshë
Alceida Rroshi



DREJTORIA E BUXHETIT

Drejtoreshë
Valbona Qirriako



DREJTORIA E TURIZMIT

Drejtor
Lorenc Smajli



DREJTORIA EKONOMIKE

Drejtoreshë
Ina Ferra



KRYETARE

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E TURIZMIT
SEKTORI I INTEGRIMIT EVROPIAN DHE NDIHMËS SË HUAJ

Nr. _____ Prot.

Durrës, më ____ . ____ . 2026

RELACION

PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 4010444 (KATËR MILIONË E) DHJETË MIJË E KATËRQIND E DYZET E KATËR) LEKË TË PARAFINANCUARA NGA PROJEKTI SUSTAINABLE MOBILITY UPGRADE - SUMO 2.0, PROGRAMI INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027)

Në mbështetje të Ligjit nr. 65/2022 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)”, Ligjit nr. 8/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Evropian, i cili përfaqëson Bashkimin Evropian, për programin e bashkëpunimit (Interreg VI-A) IPA Itali-Shqipëri-Mali i Zi (Adriatiku Jugor) 2021-2027”, Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr.10 datë 12.07.2024 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, Marrëveshjes së Partneritetit të nënshkruar ndërmejt Partnerit udhëheqës së Projektit Luka Bar AD dhe institucionit të Bashkisë Durrës, nënshkruar më datë 01/09/2025, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Turizmit kanë përgatitur Relacionin për alokimin e fondeve të parafinancuara nga Projekti Sustainable Mobility Upgrade 2.0 - SUMO 2.0, programi i BE-së Interreg IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027).

Referuar Marrëveshjes së Partneritetit të nënshkruar ndërmejt Partnerit udhëheqës së Projektit Luka Bar AD dhe institucionit të Bashkisë Durrës, nënshkruar më datë 01/09/2025, Bashkia Durrës është përfutuese e projektit Sustainable Mobility Upgrade 2.0 - SUMO 2.0, programi i BE-së Interreg IPA SOUTH ADRIATIC (2021-2027).

Ky projekt do të zgjasë 30 muaj (1/07/2025 – 31/12/2027). Kodi i produktit të projektit të ardhur ng Dega e Thesarit Durrës dhe të konfirmuar nga Ministria e Financeve është: G107010.

Buxheti total i projektit për institucionin e Bashkisë Durrës është: 244.693,00 Euro, nga të cilat:

- **207.989,05 Euro (ose 85%)** do të financohen nga fondet e programit Interreg IPA SOUTH ADRIATIC

- **36.703,95 Euro (ose 15%)** si bashkëfinancim nga fondet e Bashkisë Durrës (nëpërmjet deklarimit të pagave të anëtarëve të grupit të punës).

Referuar Marrëveshjes së Partneritetit, menjëherë mbas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të bëhet disbursimi i shumës së paraфинancimit nga partneri udhëheqës i projektit.

Shuma e disbursimit të paraфинancimit është në vlerën 20% të shumës së financimit të projektit nga fondet e programit Interreg, pra në vlerën 41.597,81 Euro ose 4,010,444 lekë.

Transferimi i shumës së paraфинancimit në vlerën lekë është bërë në muajin mars të vitit 2026 në llogari të Projektit SUMO 2.0 me kod produkti G107010. Kjo shumë do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për zhvillim të aktiviteteve për vitin 2026 e në vazhdim, si: ekspertiza të jashtme dhe shërbime për takime lokale, udhëtime jashtë vendit, kancelari dhe përkthim/noterizim.

Qëllimi i Projektit

Qëllimi i projektit SUMO 2.0 është të zhvillojë një qasje multimodale të koordinuar det-tokë në nivel ndërkufitar, duke përdorur zgjidhje transporti të qëndrueshme dhe teknologjikisht të avancuara, për të lidhur më mirë qytetet e Adriatikut Jugor me zonat urbane, portet dhe aeroportet e tyre. Synimi final është përmirësimi i lëvizshmërisë së qytetarëve dhe pasagjerëve.

Pra, projekti SUMO 2.0 synon të:

- ulë trafikun dhe ndotjen, sidomos gjatë sezonit turistik;
- përmirësojë lidhjet mes porteve, rrugëve dhe transportit publik;
- përdorë mjete ekologjike si automjete elektrike/hybride;
- krijojë sisteme inteligjente për menaxhimin e trafikut dhe lëvizjes;
- forcojë bashkëpunimin mes Italisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Për Durrësin, kjo do të thotë lidhje më e mirë mes portit, qytetit dhe transportit urban, me përfitime për banorët dhe turistët.

Partnerët e projektit SUMO 2.0 janë nga Mali i Zi, Italia dhe Shqipëria, më konkretisht:

PP1 Porti i Barit, Mali i Zi (Partneri Udhëheqës)/ *Port of Bar JSC – Lead Partner, Montenegro*

PP2 Kompania e transportit publik në Brindisi, Itali/ *Public Transport Company Brindisi S.p.A. Italy*

PP3 Bashkia Durrës, Shqipëri/ *Durrës Municipality, Albania*

PP4 Bashkia Termoli, Itali/ *Municipality of Termoli, Italy*

Partnerët e asociuar:

Ministria e Çështjeve Detare e Malit të Zi/ *Ministry of Maritime Affairs, Montenegro*

Roli dhe përgjegjësitë kryesore të Bashkisë Durrës (PP3):

Durrësi konsiderohet nyje kyçe transporti në Adriatik, sepse porti i tij është pika kryesore hyrëse e Shqipërisë për mallra dhe pasagjerë. Për këtë arsye, Bashkia ka rol strategjik në zinxhirin ndërmodal të transportit.

Roli dhe përgjegjësitë e Bashkisë Durrës në projektin SUMO 2.0 fokusohen në zbatimin lokal të zgjidhjeve të lëvizshmërisë së qëndrueshme dhe bashkëpunimin ndërkufitar me partnerët e tjerë.

Roli kryesor i Bashkisë Durrës në këtë projekt:

- Përfaqëson Shqipërinë në projekt dhe interesat e qytetit të Durrësit.
- Kontribuon në përmirësimin e lidhjes mes qytetit, portit dhe transportit urban.
- Merr pjesë në planifikimin e strategjive të përbashkëta për transport të gjelbër dhe inteligjent.
- Përfiton dhe zbaton eksperiencat e partnerëve të tjerë në fushën e mobilitetit.

Përgjegjësitë konkrete:

- Zbatim i aktiviteteve pilot: ndërtimi i pistës çiklistike në territorin e Durrësit për një lëvizshmëri sa më efektive.
- Përfshirje në hartimin e planeve dhe roadmapeve strategjike ndërkufitare.
- Menaxhim administrativ dhe financiar i buxhetit të partnerit.
- Komunikim dhe shpërndarje informacioni me publikun dhe aktorët lokalë.
- Ofrim ekspertize për procedurat teknike dhe institucionale.

Rezultatet e përgjithshme që priten nga zbatimi i projektit:

Rezultatet kryesore të projektit SUMO 2.0 janë të lidhura me përmirësimin e transportit të qëndrueshëm dhe lidhjeve ndërkufitare në zonën e Adriatikut Jugor.

Rezultatet e parashikuara

1. Strategji ndërkufitare për transport të gjelbër dhe inovativ
Një dokument i përbashkët strategjik mes partnerëve për zgjidhje moderne transporti.
2. Roadmap strategjik për lidhjen e porteve me zonat urbane
Plan konkret për të përmirësuar lidhjet mes porteve, qyteteve dhe transportit lokal.

3. 31 zgjidhje të adoptuara ose të zgjeruara nga organizatat
Përfshin teknologji, praktika ose sisteme të reja mobiliteti që do të përdoren nga partnerët dhe institucionet përfituese.
4. Reduktim i trafikut dhe ndotjes, sidomos në qytetet-port gjatë sezonit turistik.
5. Lëvizshmëri më e mirë për qytetarët dhe turistët
6. Udhëtime më të shpejta, lidhje më efikase mes autobusëve, porteve dhe mjeteve të tjera të transportit.
7. Forcim i bashkëpunimit mes Italisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi
Me modele të përbashkëta **menaxhimi dhe planifikimi**.

Ndërkohë, për Durrësin rezultatet priten të jenë:

- përmirësim i lidhjes qytet-port;
- transport urban më modern;
- më shumë shërbime për turistët dhe pasagjerët;
- qytet më i pastër dhe më funksional.

Aktivitetet kryesore të projektit SUMO 2.0 për periudhën 2026-2027

Aktivitetet kryesore të projektit **SUMO 2.0** për periudhën **2026–2027** lidhen me tre Paketa Pune/Working Package kryesore që synojnë përmirësimin e lëvizshmërisë së qëndrueshme dhe lidhjeve port-qytet në Adriatikun Jugor.

Aktivitetet për Paketën e Punës WP 1: Vlerësim dhe Strategji për Lidhje të Qëndrueshme Port–Qytet

- Analizë e rezultateve të projekteve të mëparshme (SUMO, SUPAIR, EnerNETMob etj.).
- Identifikim i zgjidhjeve më të mira të gjelbra dhe inteligjente.
- Hartim i **Strategjisë Ndërkufitare për Transport të Gjelbër dhe Inovativ**.
- Takime teknike mes partnerëve dhe institucioneve lokale.

Aktivitetet për Paketën e Punës WP 2: Testim dhe Vlerësim i Zgjidhjeve Inovative

- Zbatim i pilot-projekteve në secilin territor partner përfshirë dhe ndërtimin e pistës çiklistike në Rrugën “Vëllazërimi” në Durrës.
- Testim i mjeteve elektrike/hibride në zona portuale ose urbane.
- Sisteme inteligjente informacioni për pasagjerët.
- Menaxhim më i mirë i trafikut dhe lëvizjes në sezon turistik.
- Monitorim i rezultateve dhe matje e ndikimit.

Aktivitetet për Paketën e Punës WP 3: Përmirësim i Lidhjeve Ndërmodale për Qytetarët dhe Pasagjerët

- Masa për lidhje më të mirë mes portit, qytetit, autobusëve dhe stacioneve.
- Plane për bileta të integruara dhe informim të përbashkët.
- Promovim i biçikletave, ecjes dhe transportit publik.
- Hartim i **Roadmap-it Strategjik** për lidhjet port-qytet.

Bashkinë Durrës

- Zbatim i aktiviteteve lokale në Durrës.
- Përmirësim i lidhjes qytet-port.
- Pjesëmarrje në strategjitë e përbashkëta.
- Promovim i transportit urban të qëndrueshëm.

Për sa më sipër, kërkojmë miratimin e përdorimit të fondit prej 4,010,444 lekë, të ardhur si parafinancim nga projekti SUMO 2.0. Ky fond do të përdoret sipas të dhënave në tabelë:

Gr.	Kap.	Programi	Llog. Ekon	Kodi i programit	Kodi i institucionit	Emri i institucionit	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Fondi në lekë
00	2	Planifikimi Urban Vendor	231	06140	2107001	Bashkia Durrës	Projekti SUMO 2.0	G107010	4,010,444

DREJTOR

Valbona Qirjako



DREJTOR

Ina Ferra



DREJTOR

Lorenc Smajli

